



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.48

27 prill

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr.11, datë 6.4.2010	Me objekt shfuqizimin e pikës 1 dhe 2 të nenit 2, nenit 3, 4 dhe 6 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, përsa përfshijnë në fushën e zbatimit të tyre funksionarët publikë vijues: gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetarin e Gjykatës së Apelit, si antikushtetuese.....	1783
Vendim i GJK nr.12, datë 14.4.2010	Me objekt shfuqizimin e togfjalëshit “...vendimi i së cilës është i formës së prerë”, në nenin 202 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i RSH-së”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	1793
Vendim i GJK nr.13, datë 14.4.2010	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	1802
Vendim i GJK nr.14, datë 15.4.2010	Me objekt: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.84, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Vlorë. 2. Detyrimi i Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Shëndetit Publik të qarkut Vlorë dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit të Shëndetit Publik të shpërblejë për dëmin financiar në sasinë prej 749 467 lekësh, plus interesat ligjorë. 3. Detyrimi i Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Shëndetit Publik të qarkut Vlorë dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit të Shëndetit Publik Vlorë të shpërblejë për dëmin jofinanciar në sasinë e vlerësuar nga Gjykata nëpërmjet ekspertëve kontabël.....	1805

VENDIM
Nr.11, datë 6.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 17.12.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.34/21 Akti, që i përket:

KËRKUES: Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Ardian Dvorani dhe z.Amarildo Laçi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Lulzim Lelçaj, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga znj.Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 1 dhe 2 të nenit 2, nenit 3, 4 dhe 6 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, përsa përfshijnë në fushën e zbatimit të tyre funksionarët publikë vijues: gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 6, 7, 42, 81/2/a, 116/1, 122, 124, 131/a, 134/1/f, 135, 138, 144, 145/1 dhe 145/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 45 dhe 49/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (këtu e në vijim “Kuvendi”) ka miratuar ligjin nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”. Objekti i këtij ligji është rregullimi i shërbimit të transportit për një kategori të caktuar funksionarësh publikë dhe nëpunësish civilë të administratës së lartë. Sipas neneve 2, 3, 4 dhe 6, të lexuara së bashku me lidhjet 1, dhe 2, bashkëngjitur ligjit, rezulton se subjekte të këtij ligji janë edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit. Ligji u ka ndërprerë këtyre funksionarëve të lartë shërbimin e transportit me automjete, shërbim që përballohej nga të ardhurat publike përmes buxheteve të institucioneve përkatëse dhe u ka caktuar një përfitim financiar mujor në shumën 35 000 lekë, për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.

2. **Kërkuksi**, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (këtu e në vijim “Unioni”), ka pretenduar se dispozitat ligjore të kundërshtuara janë antikushtetuese, duke argumentuar se:

2.1 Dispozitat e ligjit, objekt shqyrtimi, që parashikojnë kufizimin ose heqjen e përfitimeve aktuale për shërbimin e transportit që u ofrohej gjyqtarëve nga shteti janë në papajtueshmëri me nenin 138 të Kushtetutës.

2.2 Përfitimi i një shërbimi të tillë, ndërsa përbën garanci për gjyqtarin dhe unifikon kuadrin ligjor mbi statusin e tyre, përbën dhe një detyrim për pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, për të mos e cenuar. Duke hequr këtë lloj shërbimi, të cilin këto kategori funksionarësh e gëzonin për shkak të statusit të tyre, ligji ka cenuar parimin e sigurisë juridike, në komponentin e të drejtave të fituara dhe pritshmërisë së ligjshme, mbrojtur nga neni 4 i Kushtetutës.

2.3 Shërbimi i transportit, pavarësisht se nuk është parashikuar shprehimisht në ndonjë normë konkrete, është gëzuar për një kohë të gjatë nga këta funksionarë të lartë të gjyqësorit, duke u përballuar rregullisht nga buxheti i institucioneve përkatëse; në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës, si dhe me standardin kushtetues të administrimit të buxhetit nga vetë gjykatat, parashikuar nga neni 144 i saj, ligji cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësinë organizative dhe financiare të gjykatave.

2.4 Ligji, objekt shqyrtimi, cenon pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese, e cila sipas dispozitave të Kushtetutës gëzon cilësinë e një gjykate që organizohet në mënyrë të pavarur për ushtrimin e juridiksionit të gjykimit kushtetues. Duke qenë e tillë, nenet 138 dhe 144 si dispozita kushtetuese, garantuese të pavarësisë së gjykatave, gjejnë zbatim edhe për Gjykatën Kushtetuese.

2.5 Ligji i miratuar me shumicë të zakonshme, duke parashikuar rregulla që modifikojnë rrethin e të drejtave e detyrimeve e të statusit aktual të gjyqtarëve të sipërpërmendur, të cilat kanë rregullimin e tyre në Kushtetutë dhe në ligjet organike, vjen në kundërshtim me nenet 4, 6 e 81, pika 2 të Kushtetutës si dhe, me konceptet bazë të parimit të kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë.

3. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar se:

3.1 Kërkuksi, në cilësinë e një organizate jofitimprurëse, mund të legjitimohet në një gjykim kushtetues vetëm për të mbrojtur interesat profesionale, intelektuale, etike, shoqërore dhe materiale të gjyqtarëve, për arsye se nuk është pajisur me ndonjë kompetencë kushtetuese apo ligjore që të ndikojë në forcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor apo në përsosjen dhe konsolidimin e pozitës së balancuar të këtij pushteti në raport me pushtetin ekzekutiv apo ligjvënës.

3.2 Mungesa e legjitimitetit të kërkesit qëndron edhe në drejtim të kërkesës për shpalljen si antikushtetuese të dispozitave ligjore që kanë lidhje me Gjykatën Kushtetuese dhe me Gjykatën e Lartë, për shkak se këto dy institucione kushtetuese kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe të ndryshëm nga ai i gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit;

3.3 Gjyqtarët as *de jure*, dhe as *de facto* nuk i kanë pasur dhe as nuk i përfitojnë privilegje të tilla, sepse nuk ka pasur një rregullim ligjor që të normonte transportin e funksionarëve publikë apo nëpunësve civilë, me përjashtim të deputetëve.

4. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar se:

4.1 Kërkuksi nuk legjitimohet sa i përket mbrojtjes së interesave të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk provon që në përbërje të shoqatës të ketë edhe gjyqtarë të këtyre gjykatave. Gjykata Kushtetuese si organ që qëndron jashtë tri pushteteve dhe që nuk kryen funksione të mirëfillta gjyqësore, nuk mund të përfshihet në fushën e veprimtarisë së kërkesit.

4.2 Përfitimet që merr në mbrojtje kërkuksi janë të parregulluara me ligj. Këto garanci dhe përfitime duhet detyrimisht të jenë të lidhura me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, dhe jo me interesin privat individual që mund të rezultojë nga këto garanci.

4.3 Argumenti i kërkesit në lidhje me antikushtetutshmërinë e ligjit, meqenëse është miratuar me shumicë të thjeshtë, nuk qëndron, sepse shpenzimet për transportin nuk janë pjesë e statusit të gjyqësorit.

II

A. Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitit të kërkuarit

5. Çështjen e legjitimitit të kërkuarit (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese (këtu e në vijim “Gjykata”) e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, në cilësinë e “*organizatave të tjera*”, janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*).

6. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 49, pika 2, i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Unioni është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2171, datë 4.2.2008. Në statutin e shoqatës, neni 1, parashikohet: “*Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale, e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare*”. Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Neni 8 i statudit parashikon se “*...duke bashkuar gjyqtarët, shoqata ka për qëllim të ndihmojë në mbrojtjen e interesave të tyre ... materiale; të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv*”. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

7. Kërkuari legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është regjistruar brenda afatit 3-vjeçar të përcaktuar nga neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Kërkuari ka iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt dhe, sipas kërkesave të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, për t’u legjitimuar *ratione materiae* ka detyrimin të provojë interesin e tij në lidhje me çështjen, lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet misionit që ka dhe marrëdhënies juridike të cenuar nga dispozitat përkatëse të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”. Sipas statudit rezultoi se “*misioni i Unionit ka në fokus të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave profesionale dhe materiale të gjyqtarëve, në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor*”. Për t’u legjitimuar Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme që Unioni të provojë se përfaqëson të gjithë gjyqtarët, pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, që përcakton rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimitimin (*shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 2.12.2009*).

9. Gjykata çmon se edhe pretendimi i subjekteve të interesuara për moslegjitimitimin e Unionit për të mbrojtur interesat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është i pabazuar, për shkak të misionit të kërkuarit që konsiston në mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe të gjykatave në tërësi, pjesë e të cilave janë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që ushtrojnë detyrën e tyre të caktuar nga Kushtetuta dhe ligji. Në lidhje me pretendimin e subjekteve të interesuara se kërkuari nuk legjitimohet të iniciojë një gjykim në mbrojtje të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata vlerëson të nevojshme të marrë në analizë rolin dhe pozitën e Gjykatës Kushtetuese në raport me pushtetin gjyqësor.

10. Gjykata thekson se, në kuptim të Kushtetutës dhe të legjislationit, gjykatat që janë ngarkuar për të zbatuar drejtësi në Republikën e Shqipërisë iu përkasin disa juridiksioneve gjyqësore. Kështu, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i ngarkuar me ushtrimin e kontrollit gjyqësor kushtetues, ndërsa Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallëve të para përbëjnë sistemin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në bazë të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, Kuvendi ka krijuar me ligj

gjykata për fusha të veçanta. Me ligjin nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda” janë organizuar dhe funksionojnë gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit për krime të rënda. Neni 7 i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar krijimin e gjykatave administrative. Gjithashtu, në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, tashmë të shfuqizuar, kanë qenë të parashikuara edhe gjykatat ushtarake të shkallës së parë dhe të apelit, të cilat pas riorganizimit të gjyqësorit të zakonshëm, kanë kaluar si seksione të posaçme pranë tij.

11. Subjektet e interesuara pretendojnë se Gjykata Kushtetuese nuk përfshihet në listën e gjykatave, që mund të mbrohet në këtë gjykim kushtetues nga Unioni, pasi ekzistenca, organizimi dhe funksionimi i saj është parashikuar në pjesën e tetë të Kushtetutës, dhe jo në pjesën e nëntë, që ka parashikuar gjyqësorin. Gjykata thekson se, pavarësisht nga mosparashikimi në Kushtetutë i Gjykatës Kushtetuese në pjesën ku janë vendosur “Gjykatat”, ky nuk është argument i mjaftueshëm për të konkluduar se ky autoritet kushtetues nuk është gjykatë. Ekzistenca e dy pjesëve të dallueshme në Kushtetutë: Pjesa VIII - “Gjykata Kushtetuese” dhe Pjesa IX - “Gjykatat”, nuk mohon faktin që Gjykata Kushtetuese, e cila është ngarkuar të ushtrojë kontrollin gjyqësor kushtetues, është gjykatë, por përkundrazi thekson statusin e saj të posaçëm në krahasim me gjykatat e tjera, qëllimin dhe veçoritë e saj. Është vetë Kushtetuta që, nëpërmjet kompetencave me të cilat ka pajisur organin që realizon drejtësinë kushtetuese, e ka njohur atë si gjykatë.

12. Qëllimi i Gjykatës Kushtetuese është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese. Ushtrimi i këtyre funksioneve nga Gjykata Kushtetuese, të cilat parashikohen në nenet 124, 131 dhe 132 të Kushtetutës dhe në dispozitat e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nuk kanë dallim nga funksionet që kryen një gjykatë. Kështu, neni 131 i Kushtetutës parashikon kompetencat bazë të Gjykatës Kushtetuese, në drejtim të ushtrimit të gjykimit abstrakt dhe konkret të normës juridike. Në rastet kur Gjykata vendos papajtueshmërinë e normës juridike me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, norma konsiderohet e fshirë nga sistemi juridik në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit. Ky rregullim, i parashikuar në nenin 132 të Kushtetutës, i jep vendimeve të Gjykatës Kushtetuese fuqi detyruese të përgjithshme dhe përfundimtare.

13. Gjykata çmon se shkronja “f” e nenit 131 të Kushtetutës, që parashikon një nga kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, përbën, në të njëjtën kohë, edhe pikëtakimin kryesor të veprimtarisë së saj me gjykatat e juridiksioneve të tjera. Sipas kësaj dispozite, “Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”. Kjo dispozitë e Kushtetutës i jep të drejtë Gjykatës të kontrollojë vendimet e të gjitha gjykatave të sistemit të zakonshëm. Pra, përsa i përket mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit “*për një proces të rregullt ligjor*”, Kushtetuta e vendos Gjykatën Kushtetuese si trupën më të lartë të kontrollit në hierarkinë e gjykatave në Republikën e Shqipërisë.

14. Gjykata thekson se lidhja ndërmjet këtyre dy gjykatave, të dallueshme nga pikëpamja juridiksionale, përcaktohet qartë si në procedurat e gjykimit incidental, që parashikon neni 145 i Kushtetutës, ashtu dhe në rastet kur vendimet gjyqësore të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen si antikushtetuese i dërgohen për rishqyrtim gjykatës (neni 77 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese). Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që u imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë e tyre detyruese (*shih vendimin nr.14, datë 17.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kushtetuta dhe ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” përcaktojnë procedurat e formimit, bazat dhe garancitë e ushtrimit të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, si edhe statusin e gjyqtarëve të saj. Emërtimi “*gjykatë*” i organit të drejtësisë kushtetuese, që ka si mision të tij ushtrimin e kontrollit gjyqësor kushtetues, është dhënë *expressis verbis* nga vetë Kushtetuta. Nga kjo pikëpamje, Gjykata nënvizon se ky institucion i pushtetit shtetëror, i cili është quajtur “*gjykatë*” nga vetë Kushtetuta, nuk mund të konsiderohet nga subjektet e interesuara si një institucion jogjyqësor. Gjithashtu, si në Kushtetutë, edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e saj emërtohen “*gjyqtarë*”, ndërsa veprimtaria e saj

quhet “grykim”. Paga e gryqtarit të Grykatës Kushtetuese përllogaritet në referencë me pagën e Kryetarit të Grykatës së Lartë dhe ai ka të njëjtat papajtueshmëri në ushtrimin e detyrës, sikundër edhe çdo gryqtar i juridiksioneve të tjera.

16. Procedura e pranimit të ankesave dhe kërkesave, si dhe e grykimit të tyre nga Grykata Kushtetuese është shumë e ngjashme dhe, sipas rastit, edhe e njëjtë me procedurën e zbatuar në grykimin e zakonshëm. Sipas nenit 1, pika 2, të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Grykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë,” për çështje “... që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Grykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”. Vullneti i Grykatës Kushtetuese, sikundër edhe ai i çdo grykate, të cilitdo juridiksion, shprehet vetëm përmes vendimeve, të cilët në aspektin e teknikës dhe formës së përdorur, janë identike ndërmjet tyre. Këto vendime janë përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme.

17. Grykata thekson se shfuqizimi që Grykata Kushtetuese i bën vendimeve të grykatave të juridiksionit të zakonshëm është në ushtrim të funksioneve të saj gryqësore. Kjo kompetencë, të cilën Grykata e gëzon në bazë të rregullimit të parashikuar nga nenet 42 dhe 131, shkronja “f”, të Kushtetutës është në funksion jo vetëm të rregullit të njohur se “vendimi i një grykate mund të prishet vetëm nga një grykatë tjetër,” por edhe të faktit se subjektet e interesuara, duke u paraqitur para saj për të parashtruar pretendimet e tyre, e kanë njohur dhe pranuar atë si një grykatë. Edhe nga referimi në aktet ndërkombëtare, Grykata vlerëson se rekomandimi që bëhet mbi pavarësinë, eficiencën dhe rolin e gryqtarëve “është i zbatueshëm për të gjithë personat që ushtrojnë funksione gryqësore, ku përfshihen ata që trajtojnë çështje kushtetuese, penale, civile, tregtare dhe administrative”(shih rekomandimin nr. R(94) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “Mbi pavarësinë, eficiencën, dhe rolin e gryqtarëve).

18. Karakteristikat e sipërpërmendura të Grykatës Kushtetuese si organ i pushtetit shtetëror, por edhe të tjera të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji i saj organik, si p.sh. detyrueshmëria e arsyetimit të vendimeve, grykimi i pavarur dhe i paanshëm, numri i kufizuar i subjekteve që legjitimohen ta vënë atë në lëvizje, garancitë e njëjta në lidhje me shkarkimin e gryqtarit kushtetues dhe të gryqtarit të Grykatës së Lartë, etj., konfirmojnë se ajo është një grykatë, por një grykatë *sui generis*, e cila administron drejtësinë kushtetuese.

19. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Grykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* edhe përsa u përket pretendimeve të tij në mbrojtje të pavarësisë së Grykatës Kushtetuese.

III

B. Lidhur me pretendimin mbi cenimin e parimit të pavarësisë së pushtetit gryqësor dhe të ndarjes së pushteteve

20. Pretendimi kryesor i kërkuesit lidhet me cenimin që ligjvënësi i ka bërë standardit kushtetues të administrimit të buxhetit të grykatave, parashikuar nga neni 144 i Kushtetutës, nëpërmjet heqjes së shërbimit të transportit, si dhe reduktimit të strukturës së punonjësve të administratës për gryqtarët e Grykatës Kushtetuese, gryqtarët e Grykatës së Lartë dhe kryetarët e grykatave të shkallës së parë dhe të grykatave të apelit.

21. Grykata thekson se neni 7 i Kushtetutës, që parashikon se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gryqësor, nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendura, nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri, dhe as nuk dominojnë apo u nënshtrohen ndikimeve reciproke *extra-ligjore*. Demokracia kushtetuese e vendosur me këtë Kushtetutë, bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është njëri nga organet e autoritetit të shtetit dhe për pasojë, kompetencat dhe sfera e veprimtarisë së tij është përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligje (shih vendimin e Grykatës Kushtetuese nr. 12, datë 20.5.2008).

22. Grykata ka konfirmuar në jurisprudencën e saj se grykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë. Asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç grykatave të pavarura, nuk mund ta ushtrojë këtë funksion. Ky funksion i grykatave përcakton vendin e gryqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gryqtarëve (shih vendimin e Grykatës Kushtetuese nr.11, datë 2.4.2008). Pavarësia dhe kompetenca e gryqësorit si një i tërë janë të pandara nga pavarësia e

gjqtarit si individ dhe e gjykatës si institucion. Në nenin 145 të Kushtetutës deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Roli i gjyqtarit dhe gjykatave është që, ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave kushtetuese dhe të akteve të tjera ligjore për të garantuar shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në funksion të rregullimit kushtetues, të parashikuar në nenin 145, pika 1, që njeh pavarësinë e gjyqtarëve dhe nënshttrimin e tyre vetëm ndaj Kushtetutës dhe ligjeve, pika 3 e kësaj dispozite, në të njëjtën kohë, ka sanksionuar një tjetër rregullim, që ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve. Një formulim i tillë është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprimtarinë e dhënies së drejtësisë nga gjykatat dhe gjyqtarët. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh përmbajtjen e neneve 7, 42, 144 dhe 145 të Kushtetutës, Gjykata çmon se edhe roli i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007*).

23. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si *pavarësi substanciale*, që do të thotë “liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit”; *pavarësi strukturale* që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; *pavarësi organizative* që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; *pavarësi financiare*, që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitet në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara; si dhe *pavarësi personale*, që kërkon emërim në bazë të kriterëve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor.

24. Me qëllim dhënien përgjigje të pretendimeve të palëve në këtë gjykim kushtetues, Gjykata vlerëson se duhet interpretuar neni 144 i Kushtetutës, sipas të cilit, “*Gjykatat kanë buxhet të veçantë të cilin e administrojnë vetë.*” Pushteti gjyqësor është i ndarë dhe i balancuar me dy pushtetet e tjera. Pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv janë të pajisur me buxhetin e tyre, i cili është i përshtatshëm për realizimin e funksioneve kushtetuese. Pavarësisht se Kushtetuta miratimin e buxhetit të gjyqësorit e ka lënë në pushtetin e ekzekutivit dhe të legjislativit, mënyrën e administrimit të këtij buxheti e ka ngritur në një standard kushtetues, duke ia njohur vetë gjyqësorit. Gjykata thekson se nuk mund të ndërtohen gjykata të pavarura pa pajisur gjyqësorin me të gjitha garancitë kushtetuese që mund t’i shërbejnë atij për të pasur një pavarësi të qartë financiare, veçanërisht nga ekzekutivi. “Pavarësia financiare duhet kuptuar si një financim i tillë i organeve dhe institucioneve kushtetuese, i cili duhet t’u mundësojë atyre të ushtrojnë normalisht veprimtarinë për përmbushjen e funksioneve që Kushtetuta u ka ngarkuar, pa ndërhyrjen ose ndikimin e qeverisë, të politikës ose të faktorëve të tjerë të jashtëm në këtë veprimtari, gjë që do të cenonte rëndë ushtrimin e kompetencave të tyre” (*shih vendimin nr.19, datë 3.5.2007*). Në këtë mënyrë, parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve mund të gjejë realisht zbatim. Duke i pajisur organet që administrojnë drejtësinë me garanci të përshtatshme që lidhen me pavarësinë financiare, nga njëra anë minimizohet rreziku i vënies së gjyqësorit nën ndikimin e pushteteve të tjera dhe, nga ana tjetër, u jepet gjyqtarëve një ndjenjë e nevojshme dinjiteti dhe krenarie për profesionin që ushtrojnë.

25. Gjykata çmon se përgjegjësia për buxhetin passjell kompetenca të mëtejshme, pasi buxheti përmban një numër të caktuar të kategorive të shpenzimeve, si për shembull për punonjësit e administratës, investimet, shpenzimet operative etj. Koncepti i sovranitetit në lidhje me administrimin e buxhetit do të thotë që institucioni që administron buxhetin është i lirë, në respekt të ligjit, të përcaktojë apo ripërcaktojë fondet buxhetore midis këtyre kategorive. Përgjegjësia për buxhetin është e lidhur gjithashtu edhe me kompetenca administrative, të cilat përfshijnë jo vetëm fuqinë për të emëruar dhe shkarkuar personelin, por edhe kompetencën për të lidhur kontrata, për të realizuar blerje, si dhe kompetenca të tjera. Nga ana tjetër, koncepti i pavarësisë financiare dhe i autonomisë buxhetore kërkon që organeve të pushtetit gjyqësor dhe Gjykatës Kushtetuese, si organe kushtetuese që qëndrojnë përkrah ekzekutivit dhe legjislativit, duhet t’u merret mendim, kur për arsye të jashtëzakonshme, mund të ketë shkurtime apo bllokime të fondeve që përbëjnë buxhetin e tyre. Gjykata thekson se edhe në raste të kësaj natyre, në respekt të standardit kushtetues të *administrimit vetë të buxhetit të tyre*, ndërhyrja e ligjvënësit apo ekzekutivit për të ulur buxhetin gjyqësor, qoftë dhe si një përpjekje për të shmangur deficitin buxhetor, do të konsiderohej e pajustifikuar, pa një konsultim me vetë gjyqësorin.

26. Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, Gjykata rithekson se pavarësia e gjyqësorit nuk mund të kuptohet pa vetëqeverisjen e tij, brenda së cilës përfshihet edhe organizimi i punës në gjykatë dhe ushtrimi i veprimtarisë së trupave gjyqësorë. Për këtë arsye, Kushtetuta, në nenin 144 të saj, ka sanksionuar të drejtën e gjykatave për të pasur një buxhet të veçantë dhe, ajo që është më thelbësore, për ta administruar vetë këtë buxhet. Një rregullim i tillë kushtetues, nga njëra anë, u ka njohur gjykatave një lloj autonomie në mundësinë për të propozuar buxhetin e tyre sipas ligjit por, nga ana tjetër, ka sanksionuar një pavarësi financiare në drejtim të administrimit të këtij buxheti. Janë pikërisht aspektet e pavarësisë financiare, të cilat lidhen me konceptet e sipërcituara për *autonominë buxhetore*, ato që nuk lejojnë, nga pikëpamja kushtetuese, ndërhyrjen e pushteteve të tjera në administrimin e buxhetit të gjyqësorit.

27. Rregullimi i prezantuar nga ligji nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, duke përfshirë në kategorinë e “funksionarëve publikë” edhe gjyqtarët, ka ndërprerë një zë të veçantë në buxhetin e institucioneve gjyqësore dhe pikërisht atë që lidhet me shërbimin e transportit për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe kryetarët e gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë. Mbi bazën e këtij rregullimi ligjor është nxjerrë vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1139, datë 24.11.2009 “Për caktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore.”

Nëpërmjet këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të automjeteve dhe të shoferëve që do të jenë në dispozicion të tyre, duke ndërhyrë në këtë mënyrë në strukturën e institucioneve, ç’ka cenon në të njëjtën kohë standardin kushtetues të administrimit të buxhetit nga vetë gjykatat. Përmes ligjit objekt shqyrtimi dhe aktit nënligjor që ka dalë në zbatim të tij, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë prekur të drejtën e administrimit të buxhetit, që sipas Kushtetutës bëhet nga vet gjykatat, ligjvënësi dhe ekzekutivi i kanë trajtuar gjykatat dhe gjyqtarët, efektivisht, si të ishin pjesë e administratës shtetërore. Kjo mënyrë veprimi, në vlerësimin e Gjykatës, është një ndërhyrje e pajustificuar në pushtetin gjyqësor që për rrjedhojë ka sjellë dhe cenimin e pavarësisë së këtij pushteti.

28. Sipas Kushtetutës, përcaktimi i politikave shtetërore dhe nismave ligjvënëse i përket ekzekutivit dhe legjislativit, pa cenuar thelbin e shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Ndjekja e një procedure të tillë me strukturat përfaqësuese të gjyqësorit apo me organizatat profesionale të gjyqtarëve, “*në vendimmarrjet lidhur me administrimin e gjykatave, në përcaktimin e mjeteve të tyre buxhetore, si dhe në alokimin e këtyre mjeteve për gjykatat në nivel kombëtar dhe rajonal*” është një standard i gjithëpranuar edhe në aktet ndërkombëtare (*shih Kartën Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve*). Në kuptim të parimeve kushtetuese dhe të këtyre standardeve ndërkombëtare, Gjykata vlerëson se nisma ligjvënëse, përderisa lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështje të pavarësisë organizative, funksionale dhe, në veçanti, asaj financiare të organeve gjyqësore, nuk mund të mos i nënshtrohet konsultimeve të domosdoshme dhe efektive me institucionet e gjyqësorit.

29. Mbi këtë analizë kushtetuese, që lidhet me pavarësinë e gjyqësorit dhe në veçanti me standardin kushtetues të administrimit nga vetë gjykatat të buxhetit të veçantë të tyre, Gjykata konkludon se, nëpërmjet rregullimeve ligjore të sipërcituara, ligjvënësi ka ndërhyrë në mënyrë të pajustificuar në kompetencat e një pushteti tjetër, duke cenuar nenin 144 të Kushtetutës.

30. Në këtë kontekst dhe duke u mbështetur në nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata vëren lidhjen *sine qua non* ndërmjet ligjit, objekt shqyrtimi, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1139, datë 24.11.2009 “Për caktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”, i cili ka dalë në zbatim të tij. Përderisa baza ligjore mbi të cilën Këshilli i Ministrave ka marrë autorizimin për nxjerrjen e këtij akti nënligjor konsiderohet si antikushtetuese, Gjykata konkludon për papajtueshmërinë me Kushtetutën edhe të vendimit të sipërcituar të Këshillit të Ministrave, vetëm për sa përfshin në fushën e zbatimit të tij Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Gjykata vlerëson se dispozita të veçanta të këtyre dy akteve normative vijnë ndesh me nenet 7 dhe 144 të Kushtetutës, që sanksionojnë standardin kushtetues të administrimit të buxhetit nga vetë gjykatat dhe me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve.

31. Gjithashtu, në vijim të arsyetimit të mësimërm, por edhe të pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata vë në dukje se pavarësia e gjyqësorit, si një ndër vlerat demokratike mbi të cilat ndërtohet një shtet i së drejtës, përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat, të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në

fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Një pjesë e këtyre aspekteve pranohet se janë të natyrës financiare, por Gjykata vlerëson se aspekte të tilla, si përcaktimi i numrit të automjeteve dhe shoferëve, targimi i posaçëm e i dallueshëm (targat “Z”), statusi protokollar, pasaportat diplomatike dhe të tjera elemente garantuese që bashkëshoqërojnë tashmë prej vitesh një numër të caktuar gjyqtarësh për shkak të detyrës, janë në funksion të respektimit të standardeve kushtetuese të pavarësisë institucionale, të paprekshmërisë së strukturës dhe të mënyrës së administrimit të buxhetit të këtyre institucioneve të pavarura kushtetuese. Për rrjedhojë, përderisa ndërhyrja e ligjvënësit dhe e ekzekutivit nëpërmjet normave juridike që kanë nxjerrë konsiderohet në shkelje të nenit 7 dhe 144 të Kushtetutës, Gjykata e vlerëson të nevojshme që të shpallë antikushtetutshmërinë e këtyre normave juridike, objekt shqyrtimi, duke u bazuar vetëm në argumentin për cenimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe të administrimit të buxhetit nga vetë gjykatat.

32. Nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se dispozitat ligjore, objekt shqyrtimi, kanë cenuar parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve e, në veçanti, parimin e pavarësisë së gjyqësorit, parashikuar nga nenet 7, 144 dhe 145 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkesa e paraqitur nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronjat “a” dhe “c”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 50, 51 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1 dhe 2 të nenit 2, nenin 3, nenin 4 dhe nenin 6 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, për sa përfshijnë në fushën e zbatimit të tyre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetarin e Gjykatës së Apelit.

2. Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1139, datë 24.11.2009 “Për caktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore,” për sa përfshin në fushën e zbatimit të tij Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori.

Pjesërisht kundër: Vitore Tusha.

MENDIM I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

I. Lidhur me legjitimitimin e kërkesit, Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë

1. Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, në kërkesën e vet, ka argumentuar ndër të tjera se ligji objekt shqyrtimi cenon veç pavarësisë të gjyqtarëve të juridiksionit të zakonshëm edhe pavarësinë e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e cila, sipas dispozitave të Kushtetutës, gëzon cilësinë e një gjykate që organizohet në mënyrë të pavarur për ushtrimin e juridiksionit të gjykimit kushtetues.

2. Shumica, duke legjitimuar kërkesin që të iniciojë një gjykim kushtetues edhe në mbrojtje të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ka vepruar në kundërshtim jo vetëm me nenin 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, por edhe me vetë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

3. Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një shoqatë e cila në cilësinë e “organizatave të tjera” që përmend dispozita e mësipërme, bën pjesë në rrethin e subjekteve që ushtrojnë në mënyrë të kufizuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Ky qëndrim i shumicës konfirmohet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr.35, datë 10.10.2007*).

4. Megjithëse shumica i referohet në vendim nenit 1 të statutit të shoqatës, si dhe vendimit për regjistrimin e saj, në të cilin thuhet se anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm, ajo përpiket të argumentojë se në rrethin e subjekteve, interesat e të cilëve mbron kjo shoqatë, përfshihen edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Duke vepruar në këtë mënyrë shumica gabon si nga pikëpamja “de jure”, ashtu dhe “de facto”.

5. Gjykata Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, “de jure” është konceptuar sipas Kushtetutës si një organ i pavarur, jashtë sistemit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që ndryshon në mënyrë thelbësore nga këto të fundit në objektin e veprimtarisë. Sipas nenit 124 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj dhe në këtë kuptim ajo nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor i cili, po sipas Kushtetutës, ushtrohet vetëm nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë (shih nenin 135 të Kushtetutës). Arsyetimet e shumicës (shih faqen 8 të vendimit) se Gjykata Kushtetuese është quajtur nga Kushtetuta “gjykatë” dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet nga subjektet e interesuara si një institucion jo gjyqësor, janë të natyrës formale dhe nuk kanë të bëjnë me thelbin e problemit. Edhe në rastet kur kjo Gjykatë shqyrton kërkesat e individëve të cilët i drejtohen asaj, pasi të kenë shterur të gjitha mjetet e ankimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ajo në asnjë rast nuk është kompetente të shqyrtojë zgjidhjen e çështjes në themel, por vetëm aspekte të respektimit të të drejtave themelore të individit, shkelja e të cilave e bën procesin gjyqësor të parregullt.

6. “De facto”, Unionit të Gjyqtarëve si shoqatë e cila bashkon vullnetarisht gjyqtarët shqiptarë, deri më sot nuk i është bashkuar asnjë gjyqtar kushtetues, kjo edhe për faktin se kjo shoqatë është krijuar dhe njohur si e tillë vetëm për të mbrojtur interesat e gjyqtarëve “të të gjitha shkallëve të juridiksionit të zakonshëm”. Në këto kushte, Unioni nuk mund të legjitimohet për të mbrojtur interesat e personave që sipas statutit nuk bëjnë pjesë në anëtarësinë e saj.

7. Çdo lloj interpretimi i zgjeruar që mund t’i bëhet çështjes të legjitimitetit të subjekteve të ndryshme për të iniciuar një gjykim kushtetues, si në rastin në fjalë, mbart rrezikun e vënies në lëvizje të kësaj Gjykate edhe kryesisht, një tagër ky që nuk i është dhënë nga Kushtetuta në asnjë nga dispozitat e saj.

II. Lidhur me themelin e kërkesës

1. Shumica argumenton se ligji objekt shqyrtimi cenon pavarësinë e gjyqësorit, e cila ndër të tjera përfshin edhe pavarësinë financiare. Duke iu referuar vendimit nr.19, datë 3.5.2007 të kësaj Gjykate, shumica shprehet se “pavarësia financiare duhet kuptuar si një financim i tillë i organeve dhe institucioneve kushtetuese, i cili duhet t’u mundësojë atyre të ushtrojnë normalisht veprimtarinë për përmbushjen e funksioneve që Kushtetuta u ka ngarkuar pa ndërhyrjen e qeverisë, të politikës ose faktorëve të tjerë të jashtëm në këtë veprimtari, gjë që do të cenonte rëndë ushtrimin e kompetencave të tyre”. Dhe më poshtë shumica argumenton se duke i pajisur organet që administrojnë drejtësinë me garanci të përshtatshme që lidhen me pavarësinë financiare, nga njëra anë minimizohet rreziku i vënies së gjyqësorit nën ndikimin e pushteteve të tjera dhe, nga ana tjetër, u jepet gjyqtarëve një ndjenjë e nevojshme dinjiteti dhe krenarie për profesionin që ushtrojnë.

2. Mendojmë se argumentet e sipërpërmendura janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se pika 1 dhe 2 të nenit 2, neni 3, neni 4 dhe neni 6 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, si dhe vendimi përkatës i qeverisë janë të papajtueshme me nenin 7 dhe 144 të Kushtetutës.

3. Megjithëse jemi dakord me vlerësimin e shumicës se nisma ligjore në fjalë kërkonte domosdoshmërisht konsultimin me institucionet e gjyqësorit, ky fakt është i pamjaftueshëm për të shpallur ligjin objekt shqyrtimi si të papajtueshëm me Kushtetutën.

4. Automjetet, në vetvete, përbëjnë një bonus të cilin e kanë gëzuar gjyqtarët kushtetues, të Gjykatës së Lartë dhe një pjesë e drejtuesve të institucioneve gjyqësore, që nuk kanë asnjë lidhje me pavarësinë financiare të këtyre institucioneve dhe aq më pak me pavarësinë funksionale, të tilla që mund të ndikojnë sadopak në ushtrimin në mënyrë të pavarur të kompetencave nga ana e tyre. Për më tepër

përfitimi i këtij lloj bonusi është vazhdimi i një praktike të trashëguar por të pambështetur në ligj. Edhe në rast se bonusi në fjalë apo dhe të tjera të ngjashme me të, do të kishin një rregullim ligjor, në çdo rast do të kishte vend për subjektivizëm në dhënien e tyre. Heqja e tyre dhe zëvendësimi me një nivel trajtimi adekuat siç ka tentuar të bëjë ligjvënësi, do të ishte rruga më e mirë për mbrojtjen e dinjitetit dhe forcimin e pavarësisë të gjyqtarëve.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori

MENDIM I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës lidhur me legjitimitimin e kërkuarit, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, për shfuqizimin e dispozitave të ligjit objekt shqyrtimi që kanë të bëjnë me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Unioni i Gjyqtarëve ka pretenduar se disa nga normat e kundërshtuara cenojnë pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese, gjë që passjell cenimin edhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Në funksion të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në "... organizata të tjera" të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës. Në vështrim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.03.2008; nr.17, datë 25.7.2008; nr.31, datë 2.12.2009*).

Unioni është person juridik (shoqatë) i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2171, datë 4.2.2008, misioni dhe qëllimi i veprimtarisë të së cilit është, ndër të tjera: "*të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe përsosjen e konsolidimit e pozitës së balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv dhe të ndihmojë në mbrojtjen e interesave profesionale, intelektuale, etike, shoqërore dhe materiale të gjyqtarëve*". Kërkuari ka iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt, prandaj në vështrim të kërkesave të nenit 134, pika 2, për t'u legjitimuar *ratione materiae*, Unioni ka detyrimin të provojë interesin e tij, pra lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet misionit të tij dhe pasojave të zbatimit të normave objekt kundërshtimi që sjellin pasoja për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Jam e mendimit se në përputhje me standardet e kësaj Gjykate, kërkuari nuk justifikon interesin e tij për arsyet e mëposhtme. Gjykata Kushtetuese parashikohet nga Kushtetuta si organ kushtetues, kjo për shkak të funksioneve që ushtron dhe pozicionit të pavarur në raport me organet e tjera. Kushtetuta në pjesën e VIII (nenet 124-134) ka parashikuar mënyrën e formimit, funksionimit dhe raportet e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese me pushtetet e tjera. Duke qenë një organ kushtetues i pavarur, Gjykata Kushtetuese nuk është përfshirë në sistemin e gjykatave të zakonshme, të cilat në vetvete përfaqësojnë një tjetër pushtet të pavarur, pikërisht pushtetin gjyqësor. Neni 124 i Kushtetutës, i njeh Gjykatës Kushtetuese kompetencën ekskluzive të garantojë respektimin e Kushtetutës dhe të bëjë interpretimin përfundimtar të saj. Kjo kompetencë ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese në raport me të gjitha aktet e nxjerra nga pushtetet e tjera, pa u kufizuar vetëm në vendimet e gjykatave të zakonshme. Emërtimi "gjykatë" nuk e bën Gjykatën Kushtetuese pjesë të sistemit gjyqësor. Çdo lloj interpretimi i zgjeruar që mund t'i bëhet çështjes të legjitimitetit të kërkuarit nuk justifikon lidhjen e domosdoshme midis misionit të Unionit dhe normave të ligjit të kundërshtuar që kanë të bëjnë me një organ kushtetues të pavarur që nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor.

Për këtë arsye, mendoj se, mbështetur në nenin 134, pika 1 germa "f" dhe 134, pika 2, Unioni nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së normave të ligjit që kanë lidhje me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr.12, datë 14.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, më datën 9.7.2009, mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen me nr.14/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Apelit Gjirokastër.

SUBJEKTE TE INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, në mungesë.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Marsida Xhaferllari.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i togfjalëshit “...vendimi i së cilës është i formës së prerë”, në nenin 202 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i RSH-së”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a, 134/d,145/2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Kujtim Puto; përfaqësuesen e subjektit të interesuar Këshilli i Ministrave, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Shtetasi K.L., pronar i një autoveture, u gjobit me 1000 lekë nga punonjësi i Policisë Rrugore të komisarariatit të policisë Gjirokastër për qarkullim pa dokumentacionin e nevojshëm, parashikuar si kundërvajtje administrative nga neni 178/1 i Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Mbi ankimin e shtetasit, Komisioni i Apelit në Komisariatin e Policisë Gjirokastër, me vendimin nr.274 datë 6.10.2008 e ricilësoi shkëljen e tij si “qarkullim me një targë të një automjeti tjetër” dhe, në bazë të nenit 99/12 të Kodit Rrugor, e dënoi me 30 000 lekë gjobë e me konfiskimin e automjetit. Shtetasi K.L., në bazë të nenit 202 të Kodit Rrugor iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila me vendimin nr.1744 datë 17.10.2008 anuloi vendimin e Komisionit për masën e gjobës dhe atë të konfiskimit të mjetit. Gjykata, në përputhje me parashikimin e nenit 202 të Kodit Rrugor, u shpreh se vendimi i saj është i formës së prerë.

Komisariati i Policisë Gjirokastër ka ankimuar vendimin nr.1744, datë 17.10.2008 në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Kjo e fundit, pasi çeli seancën gjyqësore për shqyrtimin e këtij ankimi, bazuar në nenet 450 dhe 451 të KPC, arriti në përfundimin se togfjalëshi i nenit 202 të Kodit Rrugor “...vendimi i së cilës është i formës së prerë”, nuk lejon shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative të qarkullimit rrugor nga gjykatat më të larta dhe si i tillë, vjen në kundërshtim me nenin 43 të Kushtetutës. Bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, kjo gjykatë vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes dhe i kërkoi Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të togfjalëshit të mësipërm të nenit 202 të Kodit Rrugor.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, duke çmuar si jokushtetuese dispozitën e kundërshtuar, ka parashtruar:

- Neni 202 i Kodit Rrugor iu mohon palëve të drejtën kushtetuese të ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, ndërsa neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i lejon çdo pale, pa kufizim, të ankimojë vendimin e një gjykate në një gjykatë më të lartë.

Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar këto shkaqe për rrëzimin e kërkesës.

- E drejta që neni 145/2 i Kushtetutës u njeh gjyqtarëve për të kërkuar shfuqizimin e normës ligjore që ata e çmojnë se vjen në kundërshtim me Kushtetutën është një e drejtë që u lind kur janë duke gjykuar një çështje konkrete. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk ka filluar gjykimin e çështjes, sepse ajo është zgjidhur me vendim gjyqësor që, *ipso lege*, është i formës së prerë dhe kundër të cilit që nuk lejohet të paraqitet ankim. Vlerësimi i këtij fakti në bazë të nenit 450 germa “c” të KPC-së i përket gjykatës që ka dhënë vendimin, (që në rastin konkret është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër). Gjithashtu, në bazë të nenit 452 të KPC gjykimi në gjykatën e apelit zhvillohet për të gjitha vendimet e dhëna nga gjykatat e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj.

- Vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër i mungon “...paraqitja e arsyeve dhe analiza e ligjit që e bindin këtë gjykatë të çmojë se kjo normë është e papajtueshme me Kushtetutën”. Arsyetimi i saj nuk përmbush standardet minimale të një arsytimi vendimi, duke shkelur në këtë mënyrë detyrimin kushtetues të sanksionuar në nenin 142/1 të Kushtetutës. Kjo shkelje, sipas subjektit të interesuar, bëhet flagrante në një gjykim kushtetues në kohën kur Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar qëndrimin se arsyetimi i vendimeve gjyqësore, si detyrim kushtetues i gjykatave, përbën jo vetëm pjesë të procesit të rregull ligjor, por edhe kusht për vlefshmërinë e vetë vendimit gjyqësor.

- Neni 202 i Kodit Rrugor është në përputhje me Kushtetutën, pasi, edhe pse ky nen vendos kufizim në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të ankimit që parashikohet në nenin 43 të Kushtetutës, kufizimi është në përputhje të plotë me nenin 17 të Kushtetutës, sepse është kufizim i vendosur me ligj, për një interes publik, në përpjesëtim me gjendjen që e ka përcaktuar këtë kufizim dhe nuk cenon thelbin e së drejtës.

II

Për shkak se pala e interesuar, Këshilli i Ministrave, ka ngritur prapësime procedurale të mungesës së legjitimitetit të kërkuarit për të kërkuar shfuqizimin e nenit 202 të Kodit Rrugor të RSH-së dhe të mungesës së arsytimit të vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) gjen me vend që, përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve, t’iu përgjigjet fillimisht këtyre prapësimeve.

Gjykata konstaton se kërkuari ka legjitimitet formal për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e një ligji pasi është një nga subjektet që parashikohet si i tillë në nenin 134 germa “d” të Kushtetutës. Por, Gjykata vë në dukje se germa “d” e këtij neni është dispozitë kushtetuese e karakterit referues dhe të çon tek neni 145/2 i Kushtetutës si normë që përcakton legjitimitetin substancial të gjyqtarëve për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata i vlerëson këto dy dispozita kushtetuese si të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra tjetrën. Bazuar në to, si dhe në nenin 68 të ligjit nr.8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata çmon se çdo gjykatë/gjyqtar i secilës shkallë mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e ligjeve, por kjo vetëm gjatë ushtrimit të funksionit publik të gjykimit të një çështjeje dhe nëse ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis ligjit që kërkohet të shfuqizohet dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

Gjykata Kushtetuese çmon se, në çështjen në shqyrtim, jo vetëm gjykata e shkallës së parë, por edhe ajo e apelit janë gjykata kompetente për deklarimin e mospranimit të ankimit. Dispozita e nenit 450 të KPC-së ka lejuar që mospranimi i ankimit të deklarohet në çdo shkallë gjykimi dhe, ky mospranim të vendoset me vendim.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuari ka legjitimitet substancial për t’i kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e nenit 202 të Kodit Rrugor të RSH-së.

Gjykata vlerëson gjithashtu se Gjykata e Apelit Gjirokastër, në vendimin e saj pezullues, ka arritur të tregojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit, objekt kundërshtimi kushtetues, dhe zgjidhjes së

çështjes konkrete të investuar para saj, si dhe ka shprehur bindjen e gjykatës në lidhje me antikushtetutshmërinë e normës, siç parashikon standardi kushtetues i sanksionuar në nenin 145/2 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata thekson se në një gjykim incidental, gjykata dërguese, përpara se të çmojë se ligji vjen në kundërshtim me Kushtetutën, duhet të hetojë nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, ajo duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën. Gjykata e zakonshme duhet të përpiqet të interpretojë një ligj në përputhje me Kushtetutën nisur edhe nga fakti se si është interpretuar ligji konkret nga praktika gjyqësore, sidomos nga praktika gjyqësore unifikuese e Gjykatës së Lartë. Për çështjen në shqyrtim, Gjykatës Kushtetuese nuk i rezulton që të ketë pasur ndonjë mundësi që t'i lejonte gjykatës dërguese të zgjidhte çështjen konkrete duke anashkuar zbatimin e nenit 202 të Kodit Rrugor.

III

- Neni 202 i Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë ka këtë përmbajtje: *“Kundër vendimit të dënimitnga organi administrativ shtetëror mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë”*.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi ngre në thelb pretendimin se pjesa e dispozitës së mësipërme *“...vendimi i së cilës është i formës së prerë”*, iu mohon palëve të drejtën kushtetuese të ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, ndonëse kjo e drejtë është sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin deklarohet shprehimisht se, *“...kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”*.

Gjykata gjen me vend të rritshëm se e drejta themelore e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se *“...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit”* ose, *“...nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë”*. Si e tillë, e drejta e ankimit përbën një nga të drejtat themelore të njeriut dhe ajo parashikohet edhe në Konventën europiane për të drejtat e njeriut dhe në protokollin e saj shtesë. Referuar dispozitave të këtyre dokumenteve dhe sipas nenit 43 të Kushtetutës është e qartë që *“të drejtën e ankimit”* për në instancat më të larta gjyqësore e gëzon çdo individ që është gjykuar nga gjykatat. Kjo shënon një standard më të lartë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ai i *“ankimit efektiv”* që përcaktohet në nenin 13 të Konventës, nën që pranon si respektim të standardeve të Konventës lejimin e ankimit efektiv në një instancë më të lartë pa e kushtëzuar domosdoshmërisht këtë me ankimin në instancat e tjera gjyqësore. Gjykata vlerëson se standardi i nenit 43 të Kushtetutës duhet të shihet i lidhur ngushtë me *“të drejtën e apelit në çështjet penale”* përcaktuar në nenin 2 të protokollit 7 shtesë të kësaj Konvente. Tejkalinim pozitiv të mësipërm Gjykata e ka vënë në dukje edhe në vendimin e saj nr.14, datë 5.7.2005, në të cilin është shprehur se *“...e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalinim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa europiane e të drejtave të njeriut”*.

Po në këtë vendim Gjykata thekson se, *“...në nenin 6 të kësaj Konvente nuk parashikohet e drejta për të pretenduar mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore e, për pasojë, as detyrimi i shteteve palë për të ngritur gjykata apeli ose rishikimi (gjykata të larta ose kasacioni). Prandaj, sipas jurisprudencës së Strasburgut, nuk mund të konsiderohet cenim i këtij neni fakti nëse në rrugë ligjore, ligjvënësi i një prej shteteve palë në Konventë do të zëvendësonte ose anulonte (hiqte) një mjet ankimi ekzistues, të parashikuar në legjisllacionin e tij”*.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të saj, ka vënë një standard më të lartë në krahasim me Konventën europiane të të drejtave të njeriut, por kjo nuk do të thotë që e drejta e ankimit nuk mund, në mënyrë absolute, t'i shmanget kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kapitulli i të drejtave themelore, i parashikuar në Kushtetutë, ka një përmbajtje të tillë që, si rregull, nuk përjashton ndonjë të drejtë nga kufizimi dhe, në këtë kuptim, vlera e nenit 43 të Kushtetutës nuk

mund të qëndrojë e ndarë nga vlerat e tjera kushtetuese siç është dhe ajo e rasteve përjashtimore për kufizimin e një të drejte themelore. Jo vetëm kaq, por formulimi dhe kuptimi juridik i nenit 17 të Kushtetutës është i tillë që përfshin të gjitha të drejtat themelore përdërisa thekson se kufizimi i tyre nuk mund të prekë thelbin e së drejtës. Në vijim të këtij interpretimi vijnë edhe parashikimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të KPC-së (*shih nenet 450, 451, 452 dhe 472 të KPC*) lidhur me kufizimin e së drejtës së ankimit.

Gjykata vlerëson se togfjalëshi i nenit 202 të Kodit Rrugor, objekt i kundërshtimit kushtetues, vendos vërtetë një kufizim të së drejtës themelore të ankimit, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës.

Në lidhje me kriteret e kufizimeve, Gjykata, në vendimin e saj nr.14, datë 5.7.2005 është shprehur se: "...kufizimet e mundshme që mund t'i bëhen njohjes dhe ushtrimit të kësaj të drejte (pra të drejtës së ankimit), nga legjislacioni i brendshëm,duhet të plotësojnë dy kushte themelore: të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte". Sipas Gjykatës këto "...duhet të ballafaqohen para së gjithash me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke qenë gjithnjë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar. Ato nuk mund të cenojnë thelbin e së drejtës dhe në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën europiane të të drejtave të njeriut.

Kriteret e konventës për kufizimin e mundshëm të së drejtës së ankimit, jo vetëm janë ato që përfshihen brenda kërkesave të nenit 17 të Kushtetutës lidhur me kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese, por këto kufizime, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, duhet të kenë si pikë maksimale referimi pikërisht standardet e kësaj Konvente" (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 2.4.2003; nr.14, datë 5.7.2005; nr.35, datë 10.10.2007).

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata, duke vlerësuar se ndodhet para një kufizimi të të drejtave themelore e shih të nevojshme të kontrollojë dispozitën objekt shqyrtimi, duke u ndalur konkretisht te respektimi i kriterëve të kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore, parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës.

IV

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998. Neni 202 i tij nuk ka pësuar ndryshime edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës në datë 28.12.1998.

- E drejta e ankimit nuk është abstrakte, ajo është një e drejtë me karakter procedural, në mbrojtje të një të drejte tjetër. Ashtu siç rezulton nga përmbajtja e nenit 43 të Kushtetutës, e drejta e ankimit është, në radhë të parë, rrjedhojë e së drejtës për gjykim, (neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 42 i Kushtetutës). Gjykata e quan të drejtë pretendimin e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili e identifikon interesin publik me interesin për t'i dhënë fund sa më shpejt dhe me kosto sa më të ulët proceseve gjyqësore, shqyrtimi i të cilave në instancat më të larta gjyqësore bëhet i panevojshëm për shkak të llojit dhe masës së lehtë të dënimit. Interesi publik shfaqet gjithashtu edhe në nevojën e shmangies sa më shpejt të pasigurisë në lidhje me mosmarrëveshjet e këtij lloji.

Gjykata, në kufizimin e së drejtës së këtij ankimi, arrin të identifikojë edhe *mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve* që, në rastin konkret, mund të çmohet në aspekt të realizimit efektiv sa më të shpejt të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të individëve të tjerë, subjekte ose jo në gjykim.

- Proporcionalitetin e një kufizimi Gjykata e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën.

Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe *interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve*, në çështjen në shqyrtim, nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis interesit të dhënies së drejtësisë, që realizohet me anë të vendimeve gjyqësore dhe domosdoshmërisë për t'i dhënë fund sa më shpejt mosmarrëveshjeve, me qëllimin që organet gjyqësore të lirohen nga detyrimet që rrjedhin nga ngarkesa e panevojshme e punës. Kusht i domosdoshëm është që balanca të arrihet duke i dhënë qartësi së drejtës në konflikt.

Shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor janë të shumta dhe janë kthyer në një fenomen mjaft shqetësues në vendin tonë. Kjo situatë e rënduar shkakton, përveç problemeve të shumta, dhe një numër të madh mosmarrëveshjesh. Në këto kushte, legjislatori duke kufizuar ankimin në instancat më të larta gjyqësore synon, nga njëra anë të jepet drejtësi dhe nga ana tjetër, të rritet efektiviteti i masave administrative ndaj këtyre shkeljeve, duke shmangur zgjatjen e panevojshme të kohës nga momenti i kryerjes së shkeljes deri tek ekzekutimi i dënimit ndaj tyre, si dhe t'i jepet fund sa më shpejt zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve me koston më të ulët publike, duke parashikuar fillimisht shqyrtimin në instancat administrative të tyre.

Për sa më sipër Gjykata çmon se në raport me gjendjen dhe me synimin që kërkon të arrijë legjislatori, kufizimi i ankimit gjyqësor është i përshtatshëm.

Duke iu përmbytur qëndrimit se e drejta e ankimit është një e drejtë me karakter procedural që derivon nga e drejta e gjykimit dhe shërben për mbrojtjen e një të drejte tjetër, Gjykata çmon se duhet të analizojë edhe të drejtën në mbrojtje të së cilës shërben e drejta e ankimit.

Bazuar në nenin 1 të protokollit 1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut Gjykata konstaton se, e drejta e cenuar në rastin konkret, në mbrojtje të së cilës shërben e drejta e ankimit gjyqësor është e drejta e pronës. Në shumë vendime të GJEDNJ-së është pranuar se shteteve anëtare të kësaj Konvente iu është lënë një diskrecion i gjerë për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme, qoftë për të vendosur..... gjoba, qoftë edhe ose për të siguruar pagimin..... e gjobave. (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 2.4.2003; nr.14, datë 5. 7.2005, nr.35, datë 10.10.1007).

Në çështjen në shqyrtim, kufizimi i së drejtës së ankimit gjyqësor ka të bëjë me shkelje të një prej rregullave të qarkullimit rrugor, për të cilën parashikohen disa lloje dënimesh administrative, ndër të cilat ai me gjobë deri 100 000 lekë dhe ai i konfiskimit të mjetit.

Vendosja me ligj e llojit të dënimeve administrative, ashtu si dhe vetë masa e gjobave është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Por, Gjykata analizon propocionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre.

Për të bërë këtë analizë Gjykata e sheh me vend që së pari t'i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila ka vendosur tri kriteret alternative për të përcaktuar nëse një masë administrative ka elemente karakteristike penale. Këto kriteret kanë të bëjnë me klasifikimin e cenimit të së drejtës në sistemin ligjor kombëtar e lidhjen e tij me të drejtën penale ose me atë administrative ose më të dyja; me natyrën e shkeljes¹; dhe, me natyrën e shkallën e ashpërsisë së sanksionit të mundshëm². Për të vendosur nëse një shkelje është e karakterit penal në kuptim të Konventës, është e mjaftueshme që ajo të përputhet qoftë dhe me një nga kriteret e mësipërme³. Në parim, Gjykata i përmbahet qëndrimit se, nëse një masë e dhënë është administrative ndëshkimore, por ka edhe elemente karakteristike penale, gjë që e rrit shkallën e ashpërsisë së saj, individëve, mund t'u njihet e drejta themelore e ankimit gjyqësor ndaj këtyre masave sipas vlerësimit të ligjvënësit. Por, nëse shkalla e ashpërsisë së sanksionit administrativ është e lartë dhe barazohet, ose pothuajse barazohet me shkallën e ashpërsisë së një sanksioni penal individëve duhet t'u garantohet domosdoshmërisht e drejta e ankimit gjyqësor ndaj këtij vendimi.

Në lidhje me klasifikimin e shkeljes Gjykata çmon, se në sistemin kombëtar të së drejtës, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor që sanksionohen në Kodin Rrugor mund të cilësohet, në varësi të pasojave, ose si një fakt kriminal penal i rregulluar nga e drejta penale, ose si shkelje administrative e rregulluar nga e drejta administrative. Përsa i takon natyrës së shkeljes, në rastin në shqyrtim, Gjykatës i rezulton qartësisht se, *qarkullimi me një mjet të pajisur me një targë që nuk është e vetja*, e parashikuar nga pika 12 e nenit 99 të Kodit Rrugor, është shkelje e natyrës administrative për shkak, se duke e krahasuar këtë shkelje me shkeljet e parashikuara nga Kodi Penal rezulton se ajo nuk përbën një fakt

¹ Kur dispozitat përkatëse janë të karakterit të përgjithshëm (dhe jo të drejtuara vetëm te një grup i dhënë, i cili ka një status special, në mënyrën e ligjit disiplinor), parashikojnë një sjellje të një lloji të caktuar dhe e bëjnë detyrimin që pason subjekt të një sanksioni që është njëherësh frenues dhe ndëshkues, atëherë shkelja mund të cilësohet si "penale" në kuptim të nenit 6 (marrë nga vendimi i GJEDNJ *Gurepka v. Ukrainës*, i datës 6.9.2005).

² Humbja e lirisë apo gjoba të rënda janë tregues të karakterit penal të shkeljes (shiko ndër të tjera vendimet e GJEDNJ *Engel v. Holandës*, i 1984 dhe *Janosevic v. Suedisë*, i 2002).

³ Pra kriteret janë alternative dhe jo kumulative. Kjo nuk përjashton rastin e një analize kumulative, atëherë kur analiza e secilit kriter veçmas nuk mundëson arritjen e një konkluzioni të qartë për ekzistencën ose jo të akuzës penale" (shiko vendimin e GJEDNJ *Bendenoun v. Francës*, i 24.01.1994).

kriminal penal dhe, si e tillë, nuk përbën krim ose kundërvajtje penale që në bazë të nenit 29 të Kushtetutës dhe 2 të Kodit Penal autori i saj të mund të ndiqet dhe të dënohet penalisht.

Në lidhje me natyrën dhe shkallën e ashpërsisë së sanksionit të mundshëm Gjykata vlerëson se, nga natyra, gjoba si sanksion në sistemin kombëtar të së drejtës klasifikohet qoftë si masë administrative ndëshkimore, qoftë si një nga llojet e dënimeve penale të parashikuara nga Kodi Penal. Ndërsa sa i takon ashpërsisë së sanksionit Gjykata çmon se propocionaliteti i tij duhet të vlerësohet në raport me rëndësinë e shkeljes dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj.

Në lidhje me rëndësinë e shkeljes dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj Gjykata vlerëson se targa është një akt administrativ real (neni 146 i KPA-së) që konsiston në një shenjë publike të vënë nga një autoritet publik shtetëror në një mjet motorik që shërben për të identifikuar mjetin gjatë qarkullimit rrugor. Drejtimi jo i duhur i një mjeti motorik, qoftë edhe nga pakujdesia, mund të shkaktojë pasoja të rënda për jetën, shëndetin dhe pronën e individit, çka, sipas rastit, mund të sjellë përgjegjësi penale, civile ose administrative për drejtuesin e tij. Gjithashtu, nga pikëpamja e së drejtës civile drejtimi i një mjeti motorik konsiderohet burim i një rreziku të shtuar, gjë ka detyruar shumë shtete, përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë, të kushtëzojnë qarkullimin e mjetit motorik me detyrimin ligjor të sigurimit të tij për përgjegjësitë civile ndaj palëve të treta. Nxjerrja e përgjegjësive për veprimet dhe pasojat e ardhura kërkon domosdoshmërisht identifikimin e mjetit nëpërmjet të cilit identifikohet dhe pronari apo drejtuesi i mjetit.

Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se masa e gjobës nga 25 000 deri 100 000 lekë, kur mjeti qarkullon me targë të një automjeti tjetër ose të falsifikuar, është në përpjesëtim me shkeljen e bërë. Gjykata e vlerëson këtë masë administrative proporcionale edhe për arsye se kufijtë e saj janë më të vegjël se kufijtë e masave të gjobave si dënime penale, të parashikuara në nenin 34 të Kodit Penal. Nga ky këndvështrim, Gjykata, duke iu përmbajtur qëndrimit të ashpërsia e sanksionit është, më tepër sesa natyra e tij, vendimtare për të përcaktuar nëse një masë administrative ndëshkimore ka apo jo elementë penalë çmon, se në rastin në shqyrtim, masa administrative ndëshkimore e gjobës, e parashikuar në Kodin Rrugor, megjithëse ka elementë penalë është e vogël dhe, për këtë arsye, individëve mund t'u kufizohet me ligj e drejta themelore e ankimit gjyqësor, parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës.

Gjykata konstaton, gjithashtu se në çështjen objekt shqyrtimi, në referim të pikave 12 e 15 të nenit 99 të Kodit Rrugor, është zbatuar edhe *masa administrative plotësuese e konfiskimit të mjetit*. Për të vlerësuar propocionalitetin e kësaj mase Gjykata e sheh me vend që të theksojë fillimisht se, “konfiskimi” sjell kalimin e pronës së të pandehurit/gjykuarit në favor të shtetit. Ky i fundit bëhet pronar i sendit të konfiskuar pa paguar asnjë shpërblim. Këtu Gjykata gjen me vend të vlerësojë se konfiskimi nuk barazohet me shpronësimin ose me kufizimin në ushtrimin e së drejtës së pronës, të cilat sipas nenit 41 pikave 3 dhe 4 të Kushtetutës bëhen me kundërshtpërblim. Për të përcaktuar natyrën e vërtetë të sanksionit ose masës që përfaqëson konfiskimi Gjykata çmon të nevojshme të krahasojë pikën 15 të nenit 99 të Kodit Rrugor ku konfiskimi është parashikuar si masë administrative plotësuese dhe nenin 36 të Kodit Penal, në të cilin konfiskimi është parashikuar si dënim penal plotësues. Konfiskimi *si masë administrative plotësuese* jepet për një shkelje administrative, ndërsa *konfiskimi si dënim penal plotësues* jepet për një fakt të kundërligjshëm kriminal, i cili dënohet penalisht. Sipas Kodit Rrugor, konfiskimi i pronës *si masë administrative plotësuese* jepet nga një organ administrativ dhe mund të ankohet administrativisht deri në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa *konfiskimi i pronës si dënim penal plotësues* jepet nga një gjykatë dhe mund të ankohet së bashku me dënimin kryesor në gjykatat më të larta.

Nga ky krahasim Gjykatës i rezulton qartësisht se *masa administrative plotësuese e konfiskimit* ka elemente të plota dhe ekuivalente me dënimin penal plotësues, për të cilin sistemi ligjor penal kombëtar parashikon garancinë procedurale të ankimit gjyqësor. Në varësi të vlerës së pronës së konfiskuar administrativisht moslejimi i ankimit ndaj *konfiskimit* mund të jetë disproporcional me shkeljen administrative për të cilën jepet kjo masë.

Nga ky arsyetim, Gjykata arrin në përfundimin se moslejimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që rrjedh nga parashikimi i nenit 202 të Kodit Rrugor, jo në çdo rast është i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe duhet të shfuqizohet.

Por Gjykata çmon se shfuqizimi i menjëhershëm i pjesës së dispozitës së nenit 202 të Kodit Rrugor të RSH “...vendimi i së cilës është i formës së prerë” do të krijonte boshllëk ligjor dhe do të sillte efekte jo vetëm sa i takon *masës administrative plotësuese të konfiskimit*, por edhe për masat e tjera administrative të parashikuara nga Kodi Rrugor, moslejimi i ankimit të të cilave mund të mos vijë në

kundërshtim me Kushtetutën. Nga ana tjetër, ky boshllëk ligjor i krijuar mund të sjellë ndikim në të drejtat dhe liritë kushtetuese të shtetasve. Duke konfirmuar jurisprudencën e saj të mëparshme se detyrë e kësaj Gjykate nuk është të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullime ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe, me qëllim që pushtetit legjislativ t'i jepet koha e mjaftueshme për të bërë rregullimet e nevojshme ligjore që lidhen me të drejtën e ankimit për të gjitha masat administrative të parashikuara në nenin 202 të Kodit Rrugor, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës, vendosi që ky vendim të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të togfjalëshit “...vendimi i së cilës është i formës së prerë”, në nenin 202 të Kodit Rrugor.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi 6 muaj pas ditës së botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Kujtim Puto, Admir Thanza
Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Jemi kundër mendimit të shumicës, pasi sipas mendimit tonë, gjykata kërkuese nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për rastin konkret.

1. Sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të drejtën për të iniciuar procedurat në lidhje me gjykimin incidental e kanë gjyqtarët kur çmojnë se ligji është në kundërshtim me Kushtetutën.

Sipas përmbajtjes së dispozitës dhe frymës së nenit 145 të Kushtetutës, duhet të konkurrojnë dy kërkesa: njëra *objektive* - duhet të ngrihet gjatë një gjykimi, dhe tjetra *subjektive* duhet të ngrihet nga një gjykatë apo gjyqtar i caktuar me ligj. Këto dy kërkesa duhet të jenë të pranishme për çdo gjykim të iniciuar për këtë qëllim.

Pra, para së gjithash, në këto raste kemi të bëjmë me një gjykatë të caktuar me ligj.

Në lidhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata Kushtetuese ka krijuar praktikën e saj, me të cilën është shprehur se shprehja “gjykatë e caktuar me ligj”, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por dhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete⁴.

Sipas praktikës së saj, gjykimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një kërkesë e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut pasi, në kuptimin material, termi “gjykatë” ka të bëjë me funksionimin e saj për zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar dhe me një procedurë të caktuar, bazuar në ligj dhe Kushtetutë. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë para një gjykate kompetente, kërkon që kjo e fundit të ketë juridiksionin për të kryer këtë gjë dhe kompetencë të përcaktuar me ligj për këtë qëllim.

Për këtë qëllim, me “ligj” nënkuptohet si legjislacioni bazë për krijimin e gjykatës, ashtu dhe ai i përcaktimit të kompetencave të saj, në të gjitha fushat përkatëse. Duke u bazuar në këtë kriter bazë, Gjykata Kushtetuese është shprehur se, nëse gjykata nuk ka kompetenca për të gjykuar sipas legjislacionit

⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 17.4.2007.

përkatës të një vendi, ajo nuk është gjykatë e caktuar me ligj, sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

Ky përfundim mund të përlligjet duke u bazuar te parimi i shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Duke arsyetuar kështu, mund të themi se një tribunal në kuptimin ligjor karakterizohet nga funksionimi i tij, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore, sipas procedurave të përcaktuara rigorozisht me ligj⁵.

E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të përcaktuar me ligj, kërkon jo vetëm që të bëhet drejtësi sipas ligjit, por gjithashtu që ajo të duket dhe shikohet se bëhet. Parimi i paanësisë, kërkon që secili nga vendimmarrësit, qofshin gjyqtarë profesionistë apo jo, të jenë të paanshëm. Paanësia nënkupton që gjyqtari nuk duhet të ushqejë paragjykime në lidhje me çështjen e shtruar para tyre dhe që ata nuk duhet të veprojnë në mënyrë të tillë që ndihmojnë interesat e vetëm njëres palë. Ky nocion i paanësisë është kuptuar, sipas Gjykatës Europiane, dhe si barazi e armëve, që përfshihet në kuptimin e procesit të rregullt ligjor dhe që kërkon që dy palët në gjykim të kenë të njëjtat mundësi dhe të drejta për të paraqitur çështjen e tyre⁶.

Në lidhje me kërkesën me karakter objektiv, me "gjykim" kuptojmë veprimtarinë e gjyqtarit ose të gjykatës që zhvillohet në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve e që shoqërohet kurdoherë me një vendim përfundimtar. Në doktrinë ekziston mendimi se termi "gjykim" duhet kuptuar gjerë si përfshirje e veprimtarive gjyqësore që zhvillon gjyqtari i vetëm ose gjykata, mjafton që ato të kenë natyrë funksionale gjyqësore, si të natyrës procedurale, por dhe për atë materiale substanciare⁷. Veç kësaj, gjyqtari apo gjykata duhet të kenë pushtet efektiv në lidhje me normën e kundërshtuar, në kuptimin që, zbatimi i tij i takon atij ose asaj gjykate dhe jo një gjykate tjetër.

Pra, gjykata, që paraqitet me cilësinë e kërkesit, duhet të ketë juridiksionin për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi. Në të kundërtën pra, nëse nuk ka juridiksion mbi një çështje të caktuar, ajo nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nëpërmjet gjykimit incidental.

2. Rasti në shqyrtim. Shtetasi K.K. ka kundërshtuar vendimin e komisionit të apelimit të Komisarariatit të Policisë Gjyrokastër, lidhur me dënimin me gjobë pranë Gjykatës së Faktit Gjyrokastër. Kjo e fundit ka pranuar padinë dhe, me vendimin nr.1744, datë 17.10.2008 ka anuluar vendimin lidhur me vendosjen e gjobës. Në dispozitivin e vendimit përcaktohet shprehimisht se ai është vendim i formës së prerë.

Pavarësisht nga ky fakt, mbi ankimin e palës së paditur Komisarariatit të Policisë Gjyrokastër, çështja është dërguar ankim në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe, kjo e fundit, e ka caktuar atë për gjykim. Pas disa seancash, Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka pezulluar shqyrtimin e çështjes dhe e ka dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin, në nenin 202 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të shprehjes "*vendimi i së cilës është i formës së prerë*", duke u shprehur se kjo dispozitë binte ndesh me nenin 43 të Kushtetutës, që ka përcaktuar se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në gjykatën më të lartë, përveç kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Sipas mendimit tonë, kërkuesi nuk legjitimohej për të parashtruar kërkesë për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 202 të Kodit Rrugor.

Gjykata e Apelit nuk ka qenë kompetente për të shqyrtuar ankimin kundër një vendimi të formës së prerë, e si e tillë ajo s'mund dhe s'duhej të fillonte shqyrtimin e tij. Për këtë procedurë kanë gabuar si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, që ka gjykuar çështjen, dhe Gjykata e Apelit, që ka mbajtur atë çështje për gjykim.

Gjykata e Faktit Gjyrokastër nuk duhej ta dërgonte atë çështje për shqyrtim në shkallë të dytë, sepse sipas nenit 450 pika "c" të KPC-së, gjykata që ka dhënë vendimin nuk e pranon ankimin kur ai është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankimi.

Ky qëndrim është i bazuar edhe në nenin 451 pika "a" të KPC-së, sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur ndaj tij nuk mund të bëhet ankimi.

⁵ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 1.12.2005.

⁶ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese datë 1.12.2005.

⁷ Biagio Virgilio – Kontrolli i gjyqtarit të zakonshëm mbi kushtetutshmërinë e ligjeve përkatëse.

Edhe Gjykata e Apelit Gjyrokastër nuk duhej ta regjistronte çështjen për shqyrtim, sepse nuk ishte gjykatë kompetente, pasi në bazë të nenit 452 të Kodit të Procedurës Civile mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj.

Gjykata e apelit duhej të shprehej për mospranimin e ankimit, sepse ai ligjërisht ishte i formës së prerë. Duke mbajtur këtë qëndrim, gjykata kërkuese prapë nuk bëhej gjykatë kompetente, sepse gjykimi, në rastin konkret, nuk ishte gjykim themeli, por gjykim për moskompetencë. Pra, gjykata kërkuese nuk ka qenë gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes.

3. Praktika e Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim

Qëndrimi i shumicës mendojmë se bie ndesh me praktikën e saj. Për këtë fakt mund të sjellim në vëmendje vendimin nr.11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë vendim është pranuar kjo fabul e mekanizmit të çështjes. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për disa vepra penale, mes të cilave edhe për krimin e vrasjes kundër dy ose më shumë personave, parashikuar nga neni 79 germa “dh” e Kodit Penal. Dosja e prokurorisë i ka kaluar për gjykim, sipas kompetencës lëndore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në datën 3.9.2004, ndërsa më datën 22.10.2004 ka hyrë në fuqi ligji nr.9276, datë 16.9.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”. Sipas nenit 4 të këtij ligji, kompetenca lëndore e gjykimit të veprës penale të mësipërme nuk i përkiste më gjykatave të krimeve të rënda, por gjykatave të zakonshme të rretheve gjyqësore. Megjithëse ligji që ndryshoi kompetencën lëndore kishte hyrë në fuqi para gjykimit të çështjes objekt kërkese dhe megjithëse ai nuk përmbante asnjë dispozitë tranzitore për mënyrën se si do të veprohej për çështjet e regjistruara në gjykatat e krimeve të rënda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ajo e Apelit për Krime të Rënda, si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e dërguan çështjen në gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore, por e mbajtën dhe e shqyrtuan vetë atë.

Para Gjykatës Kushtetuese kërkuesi kishte pretenduar se është gjykuar nga gjykatat e krimeve të rënda për veprën penale të vrasjes kundër disa personave mbetur në tentativë, kur duhej të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, i është cenuar e drejta kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të Konventës Europiane “Mbi liritë dhe të drejtat themelore të njeriut”.

Në përgjigje ndaj pretendimeve të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese është shprehur *se shprehja “gjykatë ... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (vendimi nr.14, datë 17.4.2007 i Gjykatës Kushtetuese)*. Më poshtë arsyeton se vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Në këtë kontekst fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislationin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, në atë praktikë, ka arritur në përfundimin se, nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislationit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të konventës europiane.

Veç sa më sipër, Gjykata ka pranuar se shprehja “*gjykatë e krijuar me ligj*”, si element i procesit të rregullt ligjor i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të konventës europiane, reflekton parimin e shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

Po ashtu, Gjykata pohon se kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar.

Pra, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit.

Për këto arsye, ne mendojmë se gjykata kërkuese nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për rastin konkret.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Vitore Tusha.

VENDIM
Nr.13, datë 14.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 22.12.2009 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr.35/22 Akti, që i përket:

KËRKUES: NJAZI SHEHU

SUBJEKT I INTERESUAR: Zyra e Përmbarrimit Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1664, datë 29.12.2006, ka vendosur lëshimin e urdhrit për ekzekutimin e vendimit nr.3819, datë 22.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili përmbante detyrimin e të paditurit për t'i liruar paditësit (kërkuesit) truallin me sip.900 m² dhe për t'i kthyer shumën prej 566.800 lekë për përdorimin e tij prej vitit 1996.

Zyra e Përmbarrimit Tiranë, me vendimin nr.65/GJ1, datë 24.5.2007, vendosi refuzimin për ekzekutimin e vendimit të mësipërm për shkak se akti i ekspertimit ku është referuar vendimi gjyqësor është me të meta dhe se pala kreditore nuk disponon asnjë dokument pronësie.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.8049, datë 15.11.2007, vendosi “detyrimin e Zyrës së Përmbarrimit Tiranë për të vazhduar ekzekutimin e urdhrit nr.1664, dt.29.12.2006”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga vendimi nr.121, datë 21.5.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Mbi këtë bazë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u lëshua një urdhër i dytë për ekzekutimin e vendimit nr.8049, datë 15.11.2007, i cili detyronte Zyrën e Përmbarrimit Tiranë të fillonte ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.1664, datë 29.12.2006. Edhe pas daljes së vendimit të dytë, Zyra e Përmbarrimit Tiranë nuk ekzekutoi vendimin gjyqësor duke pretenduar si shkak mosregjistrimin e sendit në pronësi të kërkuesit dhe posedimin e tij nga një person i tretë.

Kërkuesi pretendon se ndaj tij është zhvilluar proces i parregullt, pasi:

- nuk po ekzekutohet vendimi gjyqësor i formës së prerë nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë për lirimin e truallit dhe pagimin e shumës për përdorimin e tij;
- ZRPP Tiranë nuk pranon të regjistrojë sendin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

II

1. Lidhur me pretendimin për moszekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si fazë përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, sepse vetëm pas realizimit të tij mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij. Në këtë fazë marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij ndaj kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në praktikën e saj të vazhdueshme, GJEDNJ e ka konsideruar pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ-së, të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata ka mbajtur po këtë qëndrim në vendimmarrjen e saj dhe ka pranuar se: "...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj". Më tej, "...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre" (*vendimi nr.43, datë 19.12.2007 vendimi nr.1, datë 19.1.2009, vendim nr.6, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua se ZRPP-ja ka regjistruar një kontratë dhurimi të debitorit, M.M., në favor të shtetases A.M., një muaj pas dhënies së vendimit të formës së prerë që kërkohet të ekzekutohet. Në fakt, edhe nga korrespondenca zyrtare e ZRPP pranohet se është regjistruar një kontratë dhurimi për të njëjtin send, por, siç deklorohet edhe në shkresën e kësaj Zyre, nr.9444/1 prot., datë 16.10.2008, kjo kontratë e regjistruar me numrin hipotekor 7147, datë 24.10.1996 nuk figuron në dokumentet që disponohen prej saj. Megjithatë, mbi bazën e kësaj kontrate rezulton të jetë bërë regjistrimi i pasurisë në emër të A.M. Bazuar mbi këtë fakt, zyra e përmbarrimit në përpjekje për të ekzekutuar vendimin, kur është ndodhur në pronën objekt ekzekutimi ka konstatuar se ajo posedohet jo nga debitori, por nga një person i tretë, ndaj të cilit vendimi gjyqësor dhe urdhri i ekzekutimit nuk ka efekt juridik. Për këtë arsye, zyra e përmbarrimit ka refuzuar ekzekutimin, me arsyetimin se vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk ka efekte ndaj personave të tretë që nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor.

Gjykata vlerëson se veprimet e zyrës së përmbarrimit nuk kanë qenë të plota në kuadër të realizimit të detyrës së saj për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të formës së prerë në favor të kreditorit. Bazuar në nenin 603 të KPC-së, rezulton se: "Kur përmbarruesi ligjor konstaton se sendi i paluajtshëm ndodhet në posedim të një personi të tretë, i cili ka fituar për vete posedimin e sendit, pas fillimit të çështjes për të cilën është dhënë vendimi që ekzekutohet, e vë kreditorin në posedim të sendit, duke treguar në vendim se si ka konstatuar kohën në të cilën personi i tretë ka fituar posedimin." Gjykata

çmon se kjo dispozitë nuk e lidh ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me regjistrimin e pasurisë ose pajisjen e personit me certifikatë pronësie nga ZRPP-ja, por vetëm me faktin e ekzistencës së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, i cili rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Për këtë arsye, Gjykata çmon se zyra e përmbarimit nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin gjyqësor, pra për t'i kthyer sendin objekt gjykimi kreditorit (kërkuesit), pavarësisht se posedimi i sendit i kishte kaluar një personi të tretë. Nga ana tjetër, për shkak se A.M. rezulton të jetë vënë në posedim të sendit të paluajshëm pas fillimit të procesit gjyqësor, Zyra e Përmbarimit Tiranë duhej të kishte zbatuar urdhërimin e nenit 603 të KPC duke zhveshur nga posedimi personin e tretë (A.M.) me qëllim lirim të sendit kërkuesit, sipas vendimit gjyqësor.

Për sa më lart, Gjykata çmon se Zyra e Përmbarimit Tiranë nuk ka kryer të gjitha veprimet e duhura për të vënë në vend të drejtën e fituar gjyqësisht nga kërkuesi, siç parashikohet në nenin 603 të KPC-së. Si rrjedhojë, nga ana e kësaj zyre është shkelur neni 42 i Kushtetutës që garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke mos ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë.

II. Lidhur me pretendimin për mospajisjen me certifikatë pronësie nga ZRPP Tiranë

Kërkuesi pretendon se, megjithëse ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që e njeh atë pronar të sendit, ZRPP refuzon ta pajisë me certifikatë pronësie. Kjo e fundit e justifikon veprimin e saj me argumentin se prona e kërkuesit nuk është hedhur në sistemin e ri elektronik për shkak se, për të njëjtin objekt, më parë, është regjistruar një kontratë dhurimi e bërë nga debitori në favor të një personi të tretë, A.M., ndaj të cilit vendimi gjyqësor nuk ka këto efekte, pasi nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor.

Gjykata vlerëson se vendimi gjyqësor që kërkohet të ekzekutohet nuk përmban si objekt detyrimin e ZRPP Tiranë për pajisjen me certifikatë pronësie të kërkuesit, por vetëm detyrimin e debitorit për lirim të truallit dhe kthimin e shumës kreditorit. Për këtë arsye, Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimin lidhur me mospajisjen me certifikatë pronësie të kërkuesit nga ZRPP Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të procesi të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Admir Thanza, Xhezair Zaganjori

VENDIM
Nr.14, datë 15.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha,	Anëtare	e	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 24.12.2009 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr.36/23 Akti, që i përket:

KËRKUES: ELGAKOTI

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Shëndetësisë, në mungesë

Drejtoria e Shëndetit Publik, përfaqësuar nga z. Saliko Alliaj, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.84, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Vlorë.

2. Detyrimi i Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Shëndetit Publik të qarkut Vlorë dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit të Shëndetit Publik të shpërblejë për dëmin financiar në sasinë prej 749 467 lekësh, plus interesat ligjorë.

3. Detyrimi i Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Shëndetit Publik të qarkut Vlorë dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit të Shëndetit Publik Vlorë të shpërblejë për dëmin jofinanciar në sasinë e vlerësuar nga Gjykata nëpërmjet ekspertëve kontabël.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës; dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Subjekti “Elgakoti” sh.p.k., me qendër në Elbasan në datë 25.3.1996 ka lidhur një kontratë me Drejtorinë e Kujdesit Shëndetësor Parësor (DKSHP) për reagent laborator me vlerë 300 000 lekë. Për mospagim në kohë të vlerës 250 000 lekësh, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.84, datë 4.2.1999 vendosi: “detyrimin e Drejtorisë së Shërbimit Parësor Vlorë për të paguar principalin në shumën 250 000 lekë dhe kushtin penal në shumën prej 2 880 000 lekësh për shkak të mospagesës në kohë të detyrimit”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr.395, datë 22.6.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Rekursi i ushtruar nga kërkuesi para Gjykatës së Lartë nuk u pranua për shqyrtim. Mbi bazën e kërkesës së kreditorit (kërkuesit) u lëshua urdhri i ekzekutimit nr.137, datë 9.9.1999 nga Gjykata e Rrethit Vlorë.

Zyra e Përmbartimit Vlorë vuri në zbatim këtë vendim duke ekzekutuar, me datë 8.2.2000, fillimisht, shumën prej 250 000 lekësh dhe më pas kushtin penal prej 2 880 000 lekë. Shlyerja e fundit rezultoi të jetë bërë më datë 6.6.2006.

Pas shlyerjes së të gjithë detyrimit, DKSHP paditet përsëri nga kërkuesi me objekt: pagimin e kushtit penal për vonesat në pagimin e shumës së principalit (250 000 dhe kushtit penal prej 2 880 000). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.2251, datë 11.12.2006 vendosi pushimin e gjykimit pasi paditësi nuk u paraqiti.

Kërkuesi ngre përsëri padi ndaj DKSHP me datë 27.7.2007 me objekt pagimin e kushtit penal kamatëvonesat në shumën 1 920 665. Gjykata e Shkallës së parë Vlorë rrëzoi padinë me vendimin nr.629, datë 11.3.2008.

Kërkuesi pretendon se:

- Nuk ka arritur të marrë detyrimin për dëmin moral të shkaktuar nga vonesat e pagimit të detyrimit nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik duke hasur pengesa në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, për shumën prej 47 367 lekësh.

- Ndaj tij është zhvilluar proces i parregullt, pasi detyrimi që ka caktuar gjykata nëpërmjet vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk është ekzekutuar tërësisht prej vitit 1999 deri sot. Ai pretendon se nga mosshlyerja e plotë e detyrimit nga pala debitorë jo vetëm nuk ka gëzuar të drejtën e fituar me vendim gjyqësor, por i është shkaktuar edhe dëm financiar dhe moral me vonesat e ardhura si pasojë e mungesës së vullnetit të Drejtorisë së Shëndetit Publik Vlorë.

- Debitori jo vetëm i detyrohet atij për pagesën e shumës së mbetur prej 47 367 lekësh, por edhe dëmshpërblimin për dëmin shkaktuar gjatë procesit të ekzekutimit nga pala debitorë prej 300 000 lekësh. Kjo shumë është llogaritur nga kërkuesi si shpenzime për udhëtimet, përgatitje ankesash, konsulencë juridike etj.

II

Lidhur me pretendimin për mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si fazë përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, sepse vetëm pas realizimit të saj mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij. Në këtë fazë marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij ndaj kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

GJEDNJ, në jurisprudencën e saj, e ka konsideruar pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata ka mbajtur po këtë qëndrim në vendimmarrjen e saj dhe ka pranuar se: "...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në neni 142/3 të Kushtetutës nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj". Më tej, "...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre" (*vendimi nr.43, datë 19.12.2007, vendimi nr.1, datë 19.1.2009, vendim nr.6, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata thekson se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuesit dhe sjelljen e autoriteteve publike. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve kanë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Përsa i përket sjelljes së kërkuesit, Gjykata thekson, se përdorimi nga ana e tij i të gjitha procedurave të parashikuara nga legjislacioni, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Lidhur

me sjelljen e autoriteteve publike, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, megjithëse, në një masë të madhe, zbatohet parimi se iniciativa procedurale u takon palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 1.4.2009, nr.1, datë 19.1.2009, nr.8, datë 23.3.2010*).

Gjatë shqyrtimit të çështjes dhe nga deklaratimet e kërkuarit dhe të subjektit të interesuar në seancën gjyqësore u konstatua se detyrimi që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.84, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është ekzekutuar tërësisht. Pretendimet të kërkuarit lidhur me dëmin e shkaktuar nga vonesa e shlyerjes së detyrimit gjyqësor të njohur nga vendimi nr.84, datë 4.2.1999, i është dhënë përgjigje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nëpërmjet vendimit nr.629, datë 11.3.2008. Sipas këtij vendimi, pretendimi për pagesën e kushtit penal nga DSHKP-ja është i pabazuar, pasi vonesa në shlyerje ka ardhur për faj të kreditorit, i cili nuk i është drejtuar fillimit rrugës ligjore, por asaj shkresore ndaj autoriteteve të ndryshme shtetërore, veprim i cili ka sjellë vonesë në fillimin e procedurës së ekzekutimit nga Zyra e Përmbarrimit Vlorë. Argumenti i përdorur nga gjykatat për këtë pretendim ka qenë se DSHKP-ja Vlorë ka bërë të gjitha përpjekjet për shlyerjen e detyrimit të caktuar nga gjykata, prandaj nuk mund të deklarohet vonesë apo pengesë e qëllimshme nga ana e debitorit për realizimin e së drejtës së kreditorit.

Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit nuk qëndron, pasi jo vetëm zyra e përmbarrimit, por edhe vetë debitori ka kryer të gjitha veprimet e duhura duke arritur ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.84, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili i njej kërkuarit shlyerjen e dëmit në masën e caktuar në këtë vendim.

Gjithashtu, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkuarit lidhur me vonesën në ekzekutimin e këtij vendimi, është i pabazuar. Gjykata nuk konstaton mungesë vullneti apo vonesa të paarsyeshme në procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga debitori ose zyra e Përmbarrimit Vlorë. Për më tepër, vetë kërkuari pranon se zyra e përmbarrimit ka treguar vullnet të plotë për ekzekutimin e detyrimit ndaj kërkuarit.

Për këtë arsye, Gjykata çmon se nuk ndodhet para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Admir Thanza, Xhezair Zaganjori

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 26.4.2010

Doli nga shtypi më 27.4.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë